



Tieto Edu, app për prindëritë me fëmijë në parashkollor dhe shkollë

Tieto Edu app mund të shkarkohet në mobil ose iPad/tablet si për App Store ashtu dhe për Google Play. Kyçja në Tieto Edu app bëhet me ndihmën e BankID. Nëse dëshiron të futesh në Tieto Edu app përmes kompjuterit ka një link në www.kristianstad.se/skolsystem.

Në faqen startuese e sheh ti fëmijën/fëmijët tuaj me funksione të përbashkëta. Nëse ti ke shumë fëmijë navigo në të majtë te fëmija i caktuar. Kur fëmija yt t'i këtë mbushur 18 vjet atëherë ti nuk do të mundesh ta shohësh më fëmijën tuaj në app.

Në përzgjedhjen e menysë mëse larti në të djathtë ka mundësi ta zgjedhësh gjuhën suedisht ose anglisht.

Të dhënat kontaktuese

Në përzgjedhjen e menysë mëse larti në të djathtë ka mundësi ta zgjedhësh "Të dhënat e mia kontaktuese". Këtu shfaqet adresa juaj nga regjistri i popullësisë. Është më rëndësi që ti t'i paraqitesh numrat tuaj të telefonit dhe e-postën për t'a përditësuar informacionin kontaktues.

Trajtimi i mungesave

Mungesa është një funksion ku ti mund të lajmërosh mungesën dhe t'a shihesh mungesën e raportuar për një ose më shumë fëmijë. Është më rëndësi që ti t'a lajmërosh mungesën në Tieto Edu app para se veprimtaria të fillojë për fëmijën. Lajmërimin e mungesës mund t'a bësh vetëm sot ose nesër.

Kur t'a zgjedhësh mungesën janë tri mundësi si më poshtë:

- **Lajmërimi i mungesës**, këtu ti i lajmëron mungesat e një apo më shumë fëmijëve. Ti shkon përmes faqes startuese (të gjithë fëmijët) ke zgjedhje për t'i shenjaur se për cilët fëmijë don t'a lajmërosh mungesën ose shkon përmes fëmijës së caktuar.

Ti si prind e shkruan mungesën ose për një ditë të plotë (zgjidh sot ose nesër) ose një pjesë të ditës (kohë të caktuar) ku ti zgjedhë datën dhe kohën aktuale. Mungesa e kohës së caktuar do të përdoret psh me rastin e vizitës mjekësore. Mandej zgjidhe funksionin dërgoje mungesën.

Shfaqet një konfirmim lidhur me lajmërimin e mungesës. Nëse fëmija juaj vazhdon të jetë i sëmurë duhet që lajmërimi i mungesës të bëhet çdo ditë derisa fëmija juaj të rikthehet.

Me rastin e mungesës së ditës së plotë bëhet lajmërimi i mungesës si në shkollë ashtu dhe në institucionin e kohës së lirë.



- **Mungesa e lajmëruar** këtu mund ta shohësh çka ju si prindër keni regjistruar për mungesa. Ti poashtu mund të futësh këtu dhe t'a fshish (shtype shportën e letrave) mungesën e lajmëruar nëse diçka është bërë gabim nën parakushtin që rasti nuk ka ndodhur.
- **Mungesa e raportuar** këtu mund ta shohësh atë që shkolla e ka raportuar për fëmijët tuaj . Këtu poashtu mund t'i sheh vonesat eventuale ose mungesat e paarsyeshme.

Orari shkollor

Këtu shfaqet orari shkollor për fëmijën tuaj që i frekuenton mësimet në shkollë. Data ditore tregohet me lëndë dhe orë për orën mësimore përkatëse. Ti mund të shtypësh tutje për t'i parë ditët ose javët e tjera (javët e ardhshme ose paraprake).